



PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova D.D.

Nr./No./Br. 01-1260/26
Data/Data/Datum 08-07-26
PRISTINE-PRISTINA-PRISTINA

Në bazë të nenit 8 të Ligjit për Punësim (Ligji nr. 03/L-212), Rregullores për rregullimin e marrëdhënieve të punës nr. 01-3060/24, datë 31.12.2024, si dhe Vendimit të Bordit Drejtues nr. 01-1020/26, datë 29.05.2026, PK Sh.A. më datë 08.07.2026 shpall:

KONKURS PUBLIK PËR VENDE PUNE

Titulli i pozitës: Punëtor/e Sporteli, (grada 5), 3 ekzekutues

Numri i referencës: 08/26

Përshkrimi: PK Sh.A. është duke bërë përpjekje për të zhvilluar biznesin sipas përvojave më moderne të shërbimeve postare dhe komerciale, për t'i arritur standardet ndërkombëtare në ofrimin e shërbimeve postare dhe komerciale. Në këtë aspekt, PK Sh.A. ofron mundësi të barabartë punësimi të profesionistëve që synojnë të jenë pjesë e zhvillimit të biznesit dhe kompetencave të ndërmarrjes në përputhje me metodat dhe praktikatat moderne.

Kohëzgjatja e kontratës: Konform nenit 4 dhe 15 të Rregullores për rregullimin e marrëdhënies së punës për punonjësit e Postës së Kosovës nr. 01-3060/24, datë 31.12.2024, kontrata e punës është për kohë të pacaktuar, në të cilën periudhë përfshihet edhe periudha provuese prej 6 muajsh.

Pozita e punës: Punëtor/e Sporteli

- Regjioni Prishtinë (grada 5) 1 ekzekutues
- Regjioni i Mitrovicës, (grada 5) 2 ekzekutues:
 - Një ekzekutues ne Mitrovicën Veriore
 - Një ekzekutues ne Prelluzhë.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Ofron shërbime dhe shet të gjitha produktet në sportel, përfshirë edhe implementimin e dimensioneve të parapara dhe raportimin. Është përgjegjës/e për ofrimin dhe shitjen e të gjitha produkteve dhe shërbimeve. Mban përgjegjësi për furnizim të rregullt, ngarkesë me pulla, vlera postare dhe produkte për shitje. Është përgjegjës/e për klasifikimin dhe ruajtjen e dokumentacionit manipulativ financiar në baza ditore, dekadore dhe mujore. Është përgjegjës/e për mirësjellje dhe zbatimin e Kodit të Mirësjelljes. Raporton te Kontrollori/ja i/e ndërrimit ose Përgjegjësi/ja i/e Postës në baza ditore, dekadore dhe mujore. Kryen edhe punë tjera të nevojshme, të parashtruara nga Kontrollori/ja ose Përgjegjësi/ja i/e Postës. Për punën e vet i raporton Kontrollorit të ZP/Përgjegjësit të Zyrës Postare.

Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:

Punonjësi/punonjësja, për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi/e të Punëtorit/es së sportelit duhet të ketë kualifikim të mesëm, preferohet në drejtimin e shërbimit postar.

Dokumentacioni i kërkuar

Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dokumente:

1. Aplikacionin për punësim (shkarkohet nga ueb faqja e Postës së Kosovës <https://postakosoves.com/publikime/mundesipunesimi/>).
2. Diplomën mbi shkollimin (diploma e fituar jashtë Republikës së Kosovës duhet të jetë e nostrifikuar sipas ligjit).
3. CV-në.
4. Kopjen e letërnjoftimit apo pasaportës valide.
5. Dëshminë nga gjykata kompetente që ndaj kandidatit në fjalë nuk është duke u zhvilluar procedurë penale, jo më e vjetër se 6 muaj.

Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet mund të merren online në www.postakosoves.com dhe së bashku me dëshmitë përkatëse të dërgohen nëpërmjet postës në adresën: Arkivi i PK Sh.A. - Ndërtesa kryesore e PK-së, Rr. "28 Nëntori" nr. 4, 10000 Prishtinë, deri në afatin e parapare për aplikim me shenjën "PËR KONKURS", duke e cekur titullin e vendit të punës dhe regjionin për të cilin aplikoni.

Aplikacioni dhe të gjitha dëshmitë bashkëngjiten të fotokopjuara, sepse të njëjtat nuk iu kthehen aplikantëve.

- Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.
- Aplikacionet, të cilat dorëzohen pas afatit nuk do të shqyrtohen.
- Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Vërejtje:

Dokumentacioni i dërguar për këtë konkurs duhet të jetë kopje (përveç certifikatës nën hetime të lëshuar nga Gjykata që me rastin e intervistës duhet të sillet origjinali), sepse të njëjtat nuk iu kthehen kandidatëve.

Informata të përgjithshme:

Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Konkursi është i hapur nga data 08.07.2026 dhe përfundon më datë 15.07.2026 në ora 24:00.

Kandidatët që i plotësojnë kushtet, fillimisht do t'iu nënshtrohen testit me shkrim dhe vetëm ata kandidatë, të cilët do të kalojnë testin do të hyjnë në rrethin e ngushtë dhe do t'iu nënshtrohen intervistës.

Nora Rraci

për
Kryeshefe Ekzekutive e PK Sh.A.

